

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-22/13**

**Prishtinë,  
1 tetor 2013**

Në çështjen juridike të:

**R.B**

*Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese*

kundër

**M.B**

*Pala përgjegjëse në kërkesë/ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esmë Ertezi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/159/2012 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA44574) i datës 06 qershor, 2012, pas vendimmarrjes të mbajtur më 1 tetor 2013, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e R.B e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/159/2012, të datës 06 qershor 2012 ,sa i përket ankesës ë regjistruar në KPA me numrin KPA44574.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/159/2012, të datës 06 qershor 2012 ,sa i përket ankesës ë regjistruar në KPA me numrin KPA44574.
3. Obligohet pala ankuese që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 (gjashtë dhjetë) euro, në afatin prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh ,nga data e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 17 korrik 2007, R.B e ka paraqitur kërkesën në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri posedimin e pronës-banesës që gjendet në Gjakovë, rruga e Skenderbeut nr.8 ,Hyrja e dytë në sipërfaqe prej 24,48m<sup>2</sup> (tani e tutje). Ajo pretendon se ka qenë pronar i kësaj banese sipas kontratës së blerjes së banesës të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë, me dt.10.prill.2002. Ajo ka theksuar se banesën e ka humbur për shkak rrethanave të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë, duke theksuar datën e humbjes me 17 korrik 1999.

Kërkesa është regjistruar me numër KPA44574.

Përveç kontratës së shitëbljes, paraqitësja e kërkesës ka paraqitur një sërë dokumentesh tjera, por që nuk janë relevante për këtë çështje juridike.

Kontrata e blerjes së banesës së vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë me 10 prill 2012, është vulosur me vulën e Gjykatës Komunale të para konfliktit në Kosovë 1998/1999 dhe nuk është verifikuar pozitivisht sipas raportit verifikues të AKP-ës i datës 21 shkurt 2008.

Më 20 mars 2008, zyrtarët e AKP-së shkuan te vendi ku ndodhej objekti banesor dhe konstatuan që ai shfrytëzohej nga pala e panjohur.

Me dt.06 janar 2009 pala përgjegjëse në kërkesë duke marr pjesë në procedurën e AKP-ës, ka pretenduar të drejtën ligjore të kësaj banese duke theksuar se, paraqitësi i kërkesës nuk është titullar i të drejtës pronësore për banesën e kërkuar.

Për ta mbështetur pretendimin e sajë ka paraqitur këto dëshmi edhe atë:

- Aktvendimin e Shoqërisë Aksionare “Agimi” nr.246 i dt.06 maj 1992,me këtë aktvendim konstatohet se palës përgjegjëse në kërkesë i ndahet banesa në Gjakovë në Blokun 8, rruga Skënderbeu, në sipërfaqe prej 24,48m<sup>2</sup>;
- Me Kontratën e shitblerjes të vërtetuar në Gjykatë Komunale në Gjakovë Vr.nr.498/92 i dt.19 maj 1992 , me të cilën konstatohet se pala përgjegjëse në kërkesë e ka blerë banesën që është objekt i kërkesës
- Me vendimin e HPCC/D/181/2005/A&C i dt.30 prill 2005,miratoi kërkesën e palës përgjegjëse- kërkuases së kategorisë A me nr.DS502386,duke ia kthyer asaj të drejtën pronësore për pronën e kërkuar ,ndërsa paraqitësit të kërkesës së kategorisë C me nr.DS305787 për të njëjtën banesë i është i refuzuar kërkesa; dhe
- Me vendimin e HPCC/REC/95/2007,i dt. 16 mars 2007, kërkesa për rishqyrtim e Radmila Belošević kundër vendimit të HPCC/D/181/A&C i dt.30 prill 2005 është refuzuar si e pabazuar.

Sipas raportit verifikues i dt.22 qershor 2008 të gjitha dokumentet e theksuara janë verifikuar pozitivisht nga ekipi verifikues i AKP-ës.

Më 06 qershor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC) me vendimin e tij KPCC/D/R/159/2012, e hodhi poshtë kërkesën e R.B si çështje e gjykuar apo res judicata, me arsyetimin se e njëjta kërkesë e tije për të për të njëjtën banesë e regjistruar në HPCC nr. DS305787, është shqyrtuar dhe vendosur me vendimin e formës së prerë të HPCC/D/181/A&C i dt.30 prill 2005, duke ia refuzuar kërkesën si të pabazuar.

Bazuar në kërkesën e palës përgjegjëse në kërkesë e regjistruar DS502386, me të njëjtin vendim i është kthyer në posedim dhe pranuar e drejta e pronës për banesën që është objekt i kërkesës. Kjo pikërisht sepse me vendimin HPCC/REC/95/2007 i datës 16 mars 2007, kërkesa për rishqyrtim e R.B kundër vendimit HPCC/D/181/2005/A&C i datës 30 prill është refuzuar si e pabazuar.

Më 26 nëntor 2012, vendimi iu dorëzua paraqitëses së kërkesës dhe e njëjta ushtroi ankesë në Gjykatë Supreme me 12 dhjetor 2012. Me 06 dhjetor 2012 vendimin e pranoi pala përgjegjëse në kërkesë/pala përgjegjëse në ankesë, e cila edhe pse e pranoi ankesën me 15 mars 2013 nuk paraqiti përgjigje në ankesë.

Paraqitësi i ankesës e kundërshton vendimin ankimor për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material. Ajo pretendon se Kuvendi i Komunës së Gjakovës me aktvendimin e 06 gusht 1997 ia ka ndarë banesën në shfrytëzim –qira në kohë të pacaktuar.

Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që duke ia pranuar ankesën t'i mundësohet e drejta e posedimi në banesën që është objekt i kërkesës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Pas shqyrtimit të shkresave të lendes, pretendimeve ankimore ,sipas dispozitave të nenit 194 të LPK-ës, Gjykata Supreme gjeti se: ankesa është e pabazuar.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimi ankimor është i drejtë dhe ligjshëm. Drejtë ka vepruar KPCC kur ka vendosur me vendimin ankimor që ta hedh kërkesën e R.B për shkak të çështje së gjykuar apo res judikata sipas nenit 11.4 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Kërkesa e ankuesit veç është shqyrtuar dhe vendosur me vendimin e plotfuqishëm dhe formës së prerë të HPCC/D/181/A&C i dt.30 prill 2005. Ky vendim është aprovuar me vendimin HPCC/REC/95/2007, i datës dated 16 mars 2007, me të cilin kërkesa për rishqyrtim është refuzuar dhe si e tillë ai është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

Me këtë vendim të HPCC-ës palës përgjegjëse në ankesë i është pranuar e drejta pronësore në banesën që është objekt i kërkesës dhe e njëjta i është kthyer në posedim, përderisa palës ankuese i është refuzuar kërkesa për shfrytëzimin dhe kthimin në posedim me arsyetim se ajo nuk ka mund ta fiton këtë të drejtë ngase ajo banesë i është shitur palës përgjegjëse në ankesë në bazë të kontratës së shitblerjes të vërtetuar në gjykatën Komonale në Gjakovë, Vr.nr.498/92 i dt.19 maj 1992, kjo domethënë se çështja kontestuese e njëjtë dhe midis palëve të njëjta tanimë është vendosur.

Neni 166 të LPK-ës i cili *mutatis mutandis* zbatohet sipas nenit 13.5 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, parashikon se nuk lejohet gjykimi i ri në mes palëve të njëjta për çështjen juridike ,për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, siç është rasti konkret.

Në bazë të gjendjes së tillë të konstatimeve faktike, Gjykata Supreme vlerëson se kërkesa ka të njejtën identitet subjektiv dhe objektiv dhe të njejtën bazë faktike dhe juridike si vendimi HPCC/D/181/A&C i dt.30 prill 2005. Prandaj, qartazi rezulton konkludimi juridik se kjo çështje është *res judicata*.

Vendimi ankimor nuk përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale.

Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e me zbatim të nenit 13.3.B të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenit 166 par 2 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Prandaj zbatohet, tarifa e pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.15, 10.21 dhe 10.1 UA 2008/2): 30 € .

Këto tarifa gjyqësore paguhen nga pala gjyqëhumbëse. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë është jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë dhe jo më gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Gjyqi e cakton afatin prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh. Neni 47 paragrafi 3 parashikon që në rast të mospagesës së tarifës brenda afatit, pala duhet të paguaj gjobën prej 50% të shumës së tarifës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të caktuar, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

### **Këshillë ligjore:**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Esma Erterzi , Gjyqtare e EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**